



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2878/14 prot

Datë 29.01.2024

V E N D I M
Nr. 107/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.01.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 57/2024, datë 16.01.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83646-10-13-2023, me objekt: “NSHP, BOJË FOSFORESHENTE”, me fond limit 3,000,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 26.10.2023 nga autoriteti kontraktor, “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë”.

Ankimues: Operatori ekonomik “EN-BJO” SHPK, me NIPT (K872172050), me adresë: Lagjja “Pavarësia”, Bulevardi “Ismail Qemali”, Pallati Nr.458, Hyrja Nr.11, Kati 1, Vlorë

Autoriteti Kontraktor: “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë”, me adresë: Lagjja, Kushtrimi; Rruga “Dervish Hekali” Vlorë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 16.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 57/2024, datë 16.01.2024, ku vendosi:

[...]

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “En - Bjo” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83646-10-13-2023, me objekt: “NSHP, BOJË FOSFORESHENTE”, me fond limit 3,000,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 26.10.2023 nga autoriteti kontraktor, “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë”.*
2. *Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “En - Bjo” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “En - Bjo” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 58/1 prot., datë 24.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 2878/11 prot., datë 26.01.2024, autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 57/2024, datë 16.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83646-10-13-2023, me objekt: “NSHP, BOJË FOSFORESHENTE”, me fond limit 3,000,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 26.10.2023 nga autoriteti kontraktor, “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me anë të shkresës nr. 58/1 prot., datë 24.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 2878/11 prot., datë 26.01.2024, autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 57/2024, datë 16.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83646-10-13-2023,

me objekt: “NSHP, BOJË FOSFORESHENTE”, me fond limit 3,000,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 26.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë.

Nisur nga shkresa e mësipërme e paraqitur nga autoriteti kontraktor konstatohet se ky i fundit ka zbatuar vendimin e K.P.P, por nga verifikimi i kryer në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor nuk ka pasqyruar rishikimin e arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik “EN-BJO” SHPK, në zbatim të pikës 2 të dispozitivit të vendimit K.P.P 57/2024, datë 16.01.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë, nuk ka zbatuar vendimin K.P.P 57/2024, datë 16.01.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83646-10-13-2023, me objekt: “NSHP, BOJË FOSFORESHENTE”, me fond limit 3,000,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 26.10.2023 nga autoriteti kontraktor, “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë”.
2. Autoriteti kontraktor, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

